



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.747 2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e Sali Sallteku, kandidat për Kuvend të Komunës së Rahovecit, nga radhët e Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, për shkak të keqpërdorimit të votave në Qendrat e votimit 1625A, 1612A, dhe 1610A, për Zgjedhjet Lokale 2021 , të mbajtura me datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021., mori këtë.

## **V E N D I M**

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.747/2021 i datës 03.11.2021, i ushtruar nga Sali Sallteku, kandidat për Kuvend të Komunës së Rahovecit, nga radhët e Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, për shkak të keqpërdorimit të votave në Qendrat e votimit 1625A, 1612A, dhe 1610A, për Zgjedhjet Lokale 2021 .

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 03.11.2021, ka pranuar apelin Anr.747/2021 nga Sali Sallteku, kandidat për Kuvend të Komunës së Rahovecit, nga radhët e Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se ka fakte për shkelje dhe vjedhje të votës në Qendrat e Votimit 1625A, 1612A, dhe 1610A.

Apelit nuk i ka bashkangjitur asnjë provë si dëshmi lidhur me shkeljet e pretenduara.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, se dyshon se ka pasur keqpërdorim dhe vjedhje të votave në Qendrat e Votimit në 1625A, 1612A, dhe 1610A, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur keqpërdorime dhe vjedhje të votave për kandidat të këtij subjekti politik,

ashtu siç pretendon apeluasi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë vetëm pretendime sepse pritjet e ankuesit për të marrë sa më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka pasur keqpërdorime dhe vjedhje si dhe llogaritjet e bera nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Sali Sallteku, kandidat për Kuvend të Komunës së Rahovecit, nga radhët e Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje në Qendrat e Votimit 0310e/01R, 0310e/R, 0310e/03D votave për kandidatin në fjalë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.747/2021 më datën 06.11.2021**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.